ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren, Zyra e Prokurimit***

Aktiviteti i prokurimit: **220/70010-25-11583-2-1-1** Nr. i brendshëm **70010-25-044-211**

Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i Operatorëve Ekonomikë ENG IDEA Sh.p.k. & ARCH EMPIRE L.L.C.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lideri ENG IDEA Sh.p.k. · Rr. Brigada 123,
(Adresa)

Suharekë, Republika e Kosovës — *23000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

Tel. +383 49 111 592 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Beqir Ramadani, përfaqësues i ENG IDEA Sh.p.k., lider i grupit
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

E-mail engidea16@gmail.com
(Adresa elektronike)

25.11.2026 — *(Nënshkrimi dhe vula)*
(Data e parashtrimit të kërkesës)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

NUK APLIKOHET
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi B05 u publikua më 08.04.2026 në e-Prokurimi. Dosja e Korrigjuar 2 mban datën 30.04.2026. Afati i dorëzimit dhe hapja elektronike ishin më 12.05.2026 në orën 13:00. U pranuan nëntë oferta. Kriteri i dhënies sipas Aneksit 6 është tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm, me 40 pikë për çmimin, 30 për metodologjinë dhe 30 për konceptin. B58 i rivlerësimit njofton anulimin me arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm. Data dhe ora e publikimit për llogaritjen e afatit merren nga regjistri i e-Prokurimit.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesverbali B12 shënon nëntë oferta dhe hapjen elektronike më 12.05.2026, ora 13:00. Oferta jonë është 237.093,50 EUR me TVSH.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Datë 09.11.2026 Kërkese per Rishqyrtim
Datë 16.11.2026 Vendim i AK - Reufzim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP se si ne vijim:
Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 62 Përfundimi i Akivitetit të Prokurimit
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 97 Shkeljet e rënda

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues SPITALI REGJIONAL - PRIZREN, ka udhehequr proceduren e prokurimit pme titull **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojes me nr. Prokurimi 220/70010-25-11583-2-1-1**

Me dt. 30.04.2026 është publikuar DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – SHËRBIM
Me dt. 03.11.2026 është publikuar njoftimi mbi vendimin e Autoritetit kontraktues - Ri Vleresim, përmes të cilit AK e ka bërë Anulimin e procedurës në kundërshtim me LPP.
Me dt. 09.11.2026 ne kemi parashtruar kërkesën për Rishqyrtim pranë AK- me pretendimet ankimore për të cilat konsiderojmë që AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP.
Me dt. 16.11.2026 AK ka nxjerrë Vendimin mbi kërkesën për Rishqyrtim- duke refuzuar si të pabazuar.

AK gjatë rivlerësimit të ofertave ka bere shkelje të dispozitave ligjore duke anuluar proceduren e prokurimit ne kundershtim me dispozitat ligjore neni 62 i LPP-së, si dhe duke eliminuar ofertën tonë si të papërgjegjshme pa i konsideruar faktet dhe dokumentet ne dosjen e tenderit. Në këtë rast AK ka vepruar në kundërshtiim me dispozitat ligjore duke mos i trajtuar ofertat në mënyrë profesionale, si dhe duke bere shkelje në trajtimin e barabartë të ofertave.
Gjithashtu, gjatë trajtimit të kërkesës sonë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe nenin 62 të Rregullores për Prokurimin Publik (RrPP). Këto dispozita e obligojnë AK-në që t'i shqyrtojë dhe vlerësojë veçmas pretendimet e paraqitura në kërkesë, si dhe ta arsyetojë vendimin mbi bazën e këtij vlerësimi.

Në rastin konkret, në vendimin për refuzimin e kërkesës sonë, AK ka dhënë një arsyetim të përgjithshëm duke i trajtuar të gjitha pretendimet ankimore si të pabazaura, në kundërshtim edhe me vetë vendimin e AK – së, pa i trajtuar veçmas pretendimet tona dhe pa shpjeguar arsyet e refuzimit të secilit prej tyre. Edhe pse në kërkesen tone per rishqyrtim jemi pajtuar me arsyet e eleminimit te GOE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K.; TAULANT SH.P.K dhe GOE AXIOM ENGINEERING SH.P.K.; NEWS SH.P.K. duke perforcuar edhe me tej argumentet qe keta ofertues jane te papergjeshem, AK edhe keto pretendime i ka konsideruar te pabazuara! Ne kundershtim te plote edhe me vendimin e vetë AK-se!
Andaj, konsiderojmë se AK nuk e ka përmbushur detyrimin për shqyrtim dhe arsyetim të vendimit, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Pretendimi për Anulimin e kundërligjshëm të procedurës

Vendimi i Autoritetit Kontraktues (AK) për anulimin e procedurës së prokurimit është marrë në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe nenin 43 të Rregullores për Prokurimin Publik (RrPP), të cilat përcaktojnë kushtet dhe procedurën për anulimin e një aktiviteti të prokurimit.
Në rastin konkret, AK e ka anuluar procedurën pa paraqitur bazë ligjore dhe arsye të mjaftueshme që do ta justifikonin anulimin, meqenëse ne si ofertues të vetëm GOE ENG IDEA SH.P.K. & ARCH EMPIRE L.L.C. e kemi dorëzuar ofertën në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me dispozitat përkatëse ligjore.
Arsyetimi i AK-së për anulimin nuk mbështetet në fakte dhe argumente të qëndrueshme. AK e ka devijuar ofertën tonë nga procesi i rregullt i vlerësimit të ofertave dhe nuk i ka shqyrtuar siç duhet dokumentet e përfshira në dosjen e tenderit, ndonëse oferta jonë i përmbush kërkesat e saj. Gjithashtu, AK i ka vlerësuar dokumentet në mënyrë të njëanshme dhe nuk ka siguruar trajtim të barabartë gjatë procesit të vlerësimit.
Njëherit kjo përbën shkelje të rende në kuptim të LPP-së.
Andaj kërkesa jonë i drejtohet OSHP – për vlerësim meritor të ankesës dhe të detyroj AK-në që të bëjë rivlerësimin e ofertës në pajtim me dispozitat ligjore.

Pretendimi ankimor 1

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2
Kërkesa nr.2
Pika 1.9. OE duhet te dëshmoj se ka një Inxhinier të Gjeodezisë – Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë – ose master (min 5 vjet nga diplomimi), i licencuar sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës (AKK).
Dëshmia 2. Deshmit per stafin profesional.
- Një pasqyrë tabelare të puntorëve dhe personelit të kërkuar: Emrin, mbiemrin, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.
Per stafin e kerkuar duhet te dorezohen keto dokumente e deshmi :
- Kontrata ose -Parakontrate ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt. -Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit.
Diplomat –
- Licencat Çertifikatat kopje (per inxhinjeret qe eshte kerkuar te kene çertifikata - licenca).
- CV me informatat e nevojshme sa i perket eksperiences dhe bashkangjitja e referencave per ate staf qe jane kerkuar referencat.
Sqarim 1 - AK mund të kërkoj për secilin dokument edhe dëshmi fizike.
Sqarim 2 - Aty ku thuhet pervoja e punes, gjithmon pervoja llogaritet per vitet pas diplomimit.
Sqarim 3 - Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës (bachelor apo master) duhet diploma të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës

Autoriteti Kontraktues gjatë rivlerësimit ka konstatuar së për inxhinierin e gjeodezisë nuk janë paraqitur referenca të mjaftueshme profesionale për përvojën e kërkuar. Duke e cilësuar se CV e inxhinierit nuk i përmbush kërkesën e përvojës së punës 5 vjeçare pas diplomimit si dhe referencat e paraqitura nuk dëshmojnë përvojën e kërkuar .

Ne si GOE ENG IDEA SH.P.K. & ARCH EMPIRE L.L.C. kemi paraqitur, në kuadër të pikës 1.9 të kërkesës, inxhinierin e gjeodezisë, Master Ilir Kadri Gashi. Për të kemi dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit, të cilat dëshmojnë përvojën e kërkuar të punës.

Nga dokumentet e dorëzuara vërtetohet se kandidati ka përfunduar studimet bachelor në vitin 2012 dhe studimet master më 19.07.2017. Këto dëshmi, së bashku me licencën e lëshuar nga AKK-ja me nr. 163, përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit për së paku pesë vjet përvojë nga diplomimi.

Përvoja e punës është paraqitur edhe në CV-në personale të kandidatit, ku përshkruhet qartë angazhimi i tij që nga viti 2012, fillimisht në nivelin bachelor dhe më pas, nga viti 2017, në nivelin master. Ajo mund të verifikohet edhe përmes dokumenteve të bashkëngjitura me këtë kërkesë, përfshirë deklaratat tatimore në ATK, të cilat dëshmojnë angazhimin e z. Ilir Gashi në kompaninë tonë.

Kandidati është angazhuar gjithashtu në kompani private si ekspert i gjeodezisë, kadastrit dhe GIS-it. Referencat e dorëzuara në ofertë dëshmojnë angazhimin dhe përvojën e tij të punës.

Gjatë rivlerësimit, AK-ja nuk i ka marrë parasysh dokumentet e paraqitura në ofertën tonë për inxhinierin e gjeodezisë. Konsiderojmë se ky veprim përbën shkelje të nenit 59.2 të LPP-së, si dhe të neneve 40.8 dhe 38 të RRPP-së.
Kërkojmë që pretendimi të aprovohet dhe të kërkohet nga AK që të bëj vlerësimin drejtë dhe të merrë parasysh të gjitha dokumenteve e dosjes së tenderit që mbështesin pikën 1.9 dhe në bazë të fakteve të konsideroj si të kompletuar këtë kërkesë për ofertën tonë.

Pretendimi ankimor 2

Pretendimi ankimor nr. 2 ka të bëjë me eliminimin e GOE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K.; TAULANT SH.P.K. Ne konsiderojmë se AK-ja ka vepruar drejt dhe pajtohemi me eliminimin e ofertuesit në fjalë, duke i vlerësuar arsyet e eliminimit si fakte të rëndësishme.

Theksojmë se eliminimi i këtij grupi ka bazë ligjore. Gjatë vlerësimit të dokumenteve të GOE-së në fjalë, konkretisht të Metodologjisë dhe Konceptit Ideor të GOE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; GEOPLAN & CONSULTING GROUP SH.P.K.; TAULANT SH.P.K., kemi vërejtur mangësi të shumta thelbësore dhe profesionale, të cilat e bëjnë këtë dokument të pazbatueshëm për qëllimin e procedurës së prokurimit. Mangësitë e theksuara nga AK-ja gjatë procesit të vlerësimit qëndrojnë. Përveç tyre, do të theksojmë edhe mangësitë shtesë të këtij dokumenti.

Gjatë hartimit të Metodologjisë, GOE-ja ka përdorur referenca ligjore të shfuqizuara:
- Faqe 5 – Referenca ligjore: **"Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2015 Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore".**
Ky Udhëzim Administrativ është shfuqizuar më datë **07.03.2025 me UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 03/2025 KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SHËNDETËSORE SPITALORE DHE QENDRAVE REHABILITUESE.**

- Faqe 6 – **UA Nr. 08/2014 dhe UA Nr. 09/2014.**
Këto dy Udhëzime Administrative janë shfuqizuar fillimisht më datë 07.09.2023 me UA Nr. 02/2023 dhe më pas janë shfuqizuar më datë **07.02.2025 me UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (në Shëndetësi) Nr. 02/2025 – KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SHËNDETËSORE NË INSTITUCIONET PRIVATE.**

Theksojmë se, gjatë hartimit të këtij dokumenti, GOE-ja në fjalë ka përdorur gjithashtu referenca ligjore të një shteti tjetër, në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore përkatëse dhe LPP-në, duke iu referuar **Ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, i cili është i zbatueshëm në Shqipëri:

- Faqe 43 – Kap. 1.2 METODOLOGJIA DHE HARTIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)

Shoqëria "Studio Hapsira" sh.p.k. do ta kryejë vlerësimin mjedisor në përputhje me ligjin shqiptar nr. 10 440, për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", duke u bazuar edhe në Konventën e Aarhusit, të cilën Shqipëria e ka nënshkruar.

Metodologjia e hartuar nga ky GOE, në fakt, ka mangësi të theksuara dhe nuk pasqyron natyrën dhe fushëveprimin për qëllimin e kësaj procedure. Në dokument ka deklarime që tregojnë se ai është hartuar për objekte shkollore, e jo për infrastrukturë dhe objekte spitalore.

- Në faqen 9, te kapitulli "**Hapësirat e brendshme të nyjeve sanitare**" dhe "**Laboratorët**", bëhet fjalë për objekt shkollor.
- Në faqet 10 dhe 11, te kapitulli "**Gjelbërimi publik në territore urbane**", përshkrimi nuk përputhet me qëllimin e projektit.
- Në faqen 11, te kapitulli "**Distancat e mbrojtjes dhe breza mbrojtës sanitarë**", jepet përshkrim për **objekte industriale**, i cili bie në kundërshtim me natyrën dhe fushëveprimin e procedurës dhe të projektit.
- Në faqen 12 jepet një përshkrim që nuk ndërlidhet me natyrën dhe fushëveprimin e projektit.
- Në faqen 22, te kapitulli "**Ajrosja e mjediseve**", jepet përshkrim për objekte shkollore.
- Në faqen 23, te kapitulli **1.1.2 Metodologjia**, jepet përshkrim që u referohet institucioneve në Shqipëri dhe nuk ndërlidhet me qëllimin e procedurës së prokurimit. Kjo dëshmon se dokumenti është kopjuar nga një dokument tjetër, i cili nuk është i natyrës së ngjashme dhe ka të bëjë me objekt shkollor.
- Në faqen 32, "**Projekti i Zbatimit**" i referohet planit të vendosjes së strukturës dhe përmend institucione në Shqipëri, konkretisht: **"Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Tiranës."**

Këto janë vetëm disa nga mangësitë që e bëjnë këtë dokument të pazbatueshëm. Komisioni i vlerësimit, me të drejtë, e ka konsideruar GOE-në në fjalë si të papërgjegjshme.

Bashkangjitur gjej te gjitha gjetjet e huqje e mangesi.

Në shqyrtimin e dokumentit 53-faqësh, kemi **tri referenca të shfuqizuara në Kosovë**, pjesë që përshkruajnë **shkolla dhe procedura në Shqipëri**, si dhe **mospërputhje në afatet e dorëzimit**.

1. Baza ligjore dhe standardet

Faqja	Huqja e evidentuar	Ndikimi në vlerësim
5, 9	Oferta mbështetet në **UA nr. 06/2015** për kushtet spitalore. Ky udhëzim ishte shfuqizuar nga **UA nr. 03/2025** para afatit të tenderit.	Dobëson drejtpërdrejt argumentimin për përputhjen me kushtet spitalore në fuqi. gzk.rks-gov.net
6	Për licencimin dhe kushtet e institucioneve private citohen **UA nr. 08/2014** dhe **UA nr. 09/2014**. Të dyja ishin shfuqizuar nga UA nr. 02/2023. Referencat për institucione private dhe jashtëspitalore gjithashtu nuk lidhen qartë me objektin e këtij spitali publik.	Dy referenca të tjera të shfuqizuara dhe pa arsyetim të zbatueshmërisë për këtë kontratë. gzk.rks-gov.net
5, 38–40	Për projektimin dhe mbikëqyrjen përmendet legjislacioni shqiptar. Për mbrojtjen nga rrufeja citohen kushtet e zbatimit në Shqipëri. Për mbrojtjen nga zjarri oferta mbështetet në vendimin shqiptar nr. 699 të 22.10.2004 dhe në normat që zbatohen atje.	Baza e propozuar nuk demonstron përputhjen me kërkesat përkatëse në Kosovë. Statusi i vendimit nr. 699 brenda Shqipërisë mbetet i paverifikuar në këtë shqyrtim.

43–45	Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis mbështetet në **ligjin shqiptar nr. 10 440**, planin kombëtar të mjedisit të Shqipërisë dhe procedurat shqiptare të konsultimit publik.	Pjesa për VNM duhet të tregojë si përcaktohet dhe zbatohet procedura për secilën ndërhyrje sipas kuadrit të Kosovës, përfshirë Ligjin nr. 08/L-181. gzk.rks-gov.net
6–7, 17–21, 34	Disa referenca të Eurokodeve jepen me vitin e paplotësuar **200X**. Në llogaritjet sizmike përdoren edhe **KTP N.2–89** dhe **KTP 6–1978**, pa shpjeguar raportin e tyre me Eurokodet dhe bazën që do të përdoret për objektet në Prizren.	Versioni i standardit dhe metoda përfundimtare e projektimit nuk mund të përcaktohen qartë nga oferta.

2. Objekte, lokacione dhe palë të tjera

Faqja	Huqja e evidentuar
3, 8–9, 23	Oferta kalon te ndërtimi dhe rehabilitimi i **shkollave profesionale**, fëmijët dhe mësimdhënësit si përdorues, një klasë në shkollën e re për analiza dhe rëntgen, si dhe mbledhja e të dhënave pranë bashkisë ku ndodhen shkollat. Këto pjesë nuk janë përshtatur për objektin spitalor.
10–13, 22	Përfshihen norma parkimi për banesa, gjelbërim për banor, kopshte botanike e zoologjike, zona industriale dhe furnizim me ujë për parkim e park. Për disa prej këtyre temave mund të ketë lidhje me sistemimin e jashtëm, por oferta nuk shpjegon si zbatohen në kompleksin spitalor.
24, 31–32	Për pronësinë, shpronësimin dhe lejet përmenden **ZRPP, ALUIZNI, KESH–OSHEE, AlbTelekom** dhe **Bashkia e Tiranës**. Nuk identifikohet procedura përkatëse për projektet në Prizren.
28	Për matjet gjeodezike parashikohet transformimi në **Sistemin Shtetëror Shqiptar të koordinatave**, pa identifikuar sistemin e referencës që do të përdoret për dorëzimet në Kosovë.
40–42	Masat kundër zjarrit përshkruhen edhe për hapësirat e qëndrimit dhe fjetjes së fëmijëve. Për kanalizimin jepen të dhëna nga **Tirana** dhe përdoret numri i fëmijëve e stafit mësimor. Linja e furnizimit me ujë lidhet me pikën që do të caktonte **Ujësjellës–Kanalizime sh.a. Tiranë**. Këto të dhëna nuk provojnë dimensionimin ose pikëlidhjen e rrjeteve për spitalin.
21, 25, 28, 30–31, 37, 48, 50	Detyra dhe kapacitete i atribuohen disa herë **Studio Hapsira & EGB**, ndërsa në **f. 35** detajet e tarracës dhe fasadës i atribuohen shoqërisë **"Taualnt"**. Koncepti nuk sqaron rolin e këtyre subjekteve në ofertë. Kjo duhet krahasuar me deklaratat e grupit ose të nënkontraktimit, nëse janë pjesë e dosjes së dorëzuar.
3, 50	Përmenden financimi dhe raportimi me **Ministrinë e Financave**, pa shpjeguar rolin e saj në zinxhirin e raportimit për këtë kontratë.

3. Metodologjia, qëndrueshmëria dhe afatet

Faqja	Huqja e evidentuar

13–21, 34–35	Paraqiten si të përcaktuara themelet, klasa e betonit, armatura dhe parametra sizmikë, pa treguar për cilin objekt ose studim të lokacionit vlejnë. Tabela e ngarkesave përfshin banim, ballkone, zyra dhe magazina, pa e lidhur me funksionet dhe pajisjet e reparteve spitalore. Në f. 14 përmenden **SAP2000, ETABS dhe Sta4CAD** pa sqaruar se cilit model i përkasin rezultatet e përshkruara. Në f. 16 paraqitet koeficienti i rëndësisë **1,00**, pa arsyetim për objektin spitalor.
6–9, 22–23, 37–42	Oferta përmend higjienën, sterilitetin, ventilimin, sigurinë dhe ujësjellësin, por nuk i zhvillon në një plan të qartë sipas reparteve. Nuk gjeta një përshkrim të mjaftueshëm të fazimit të punimeve në spital aktiv, ndarjes së zonave të punës nga pacientët dhe personeli, ose ruajtjes së furnizimit me ujë, energji dhe gazra mjekësorë gjatë ndërhyrjeve.
8–10, 25, 39	Përmenden mirëmbajtja, simulimi energjetik, klasa **A+** dhe kontrolli i konsumit. Nuk jepet një bazë e matshme për spitalin, me gjendjen ekzistuese, objektivat sipas ndërhyrjes dhe mënyrën e verifikimit të rezultateve.
46–50	Organogrami paraqet disiplinat dhe funksionet e përgjithshme. Lidhja mes personave përgjegjës, detyrave dhe dorëzimeve konkrete mbetet e paqartë brenda këtij dokumenti. Kjo mund të verifikohet kundrejt dokumenteve të tjera të ofertës.
51–52	Grafiku shënon **raportin fillestar në ditën 1**, ndërsa teksti e parashikon **brenda një muaji**. Grafiku vendos shënime për raportet mujore në ditët **16 dhe 31**, ndërsa teksti parashikon dorëzim në fund të çdo muaji.
51–53	Grafiku e vendos projektin final në ditët **24–28**, komentet për projektin e zbatimit pas kësaj dhe paketën përfundimtare të tenderit në fund të ditës **31**. Teksti në f. 53 parashikon dorëzimin e projektit dhe paketës një deri dy javë para përfundimit të kontratës. Nuk sqarohet si harmonizohen këto dy afate ose nëse i referohen periudhave të ndryshme. Po ashtu, shënimi për deri në **15 ditë** pritjeje për komente nuk rakordohet me intervalet e shënuara në grafik.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të vërtetojë faktet e paraqitura nga ana jonë dhe të aprovojë pretendimin tonë se ky grup i operatorëve ekonomikë (OE) nuk mund të vlerësohet me pikë për metodologjinë dhe Konceptit Ideor të ofruar.

Pretendimi ankimor 3

Pretendimi ankimor 3 ka të bëjë me kërkesën 1.6 të dosjes së tenderit:
1.6. OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master te Elektroteknikes - Drejtimi Elektronikë, kërkohet te ketë min. 7 vite përvojë pune pas diplomimit.
Pas analizës së dokumenteve është evidnetuar se Ofertuesi GOE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; GEOPLAN &CONSULTIN GROUP SH.P.K.; TAULANT SH.P.K. në dokumentet e tenderit për këtë pozitë ka ofruar inxhiner Osman Gërxhaliu dhe Shpend Lutfiu.
Nga dokumentet e dorëzuara në ofertën e OE-së rezulton se kërkesa e lartcekur nuk është përmbushur, sepse:
Inxhiner Osman gërxhaliu i mungojnë : Kontrata me inxhinierin apo Parakontrata siç specifikohet në dosjen e tenderit, CV dhe Referenca, ndërsa,
Inxhinier Shpend Lutfiu i Mungon Licenca nga OIRK sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Ky kriter është përcaktuar si kërkesë e detyrueshme për pjesëmarrje dhe për dëshmi e kapacitetit teknik dhe profesional, në kuptim të nenit 69 të LPP-së.

Konisderojmë se GOE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; GEOPLAN &CONSULTIN GROUP SH.P.K.; TAULANT SH.P.K. nuk e ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në pikën 1.6 të dosjes së tenderit dhe se oferta e tij është e papërgjegjshme.
Pra, oferta e GOE përveç mangësive të metodologjisë dhe projekt idesë, oferta ka mangësi edhe tek kërkesa e stafit profesional që e bënë të papërgjegjshëm kete grup te OE-ve.

Pretendimi ankimor 4

Pretendimi ankimor nr. 4 ka të bëjë me vlefshmërinë e ofertës së **Grupit të Operatorëve Ekonomikë AXIOM ENGINEERING SH.P.K.; NEWS SH.P.K.** Ne pajtohemi me eliminimin e tyre, po ashtu konsiderojmë dhe paraqesim fakte shtesë se ky GOE nuk i përmbush kërkesat.

Kërkesa 1.8: OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar të makinerisë, me së paku 7 vjet nga diplomimi.

Nga dokumentet e analizuara rezulton se, në listën e stafit për pikën 1.8 të kërkesës 2 të dosjes së tenderit, sipas neneve 9.1 dhe 9.2, GOE-ja ka ofruar inxhinierin Valon Rustemi. Sipas dokumenteve dhe verifikimit të tyre, inxhinieri në fjalë ka diplomuar në nivelin Master më 19.09.2022.

Meqenëse dosja e tenderit, në pikën 1.8, kërkon së paku 7 (shtatë) vjet përvojë nga diplomimi, dhe inxhinieri i ofruar ka diplomuar më 19.09.2022, konsiderojmë se afati i kërkuar në DT nuk plotësohet. Në këto rrethana, dokumentet e paraqitura nuk dëshmojnë përmbushjen e kriterit të pikës 1.8. Data e diplomimit e shënuar në dokumentacion tregon se inxhinieri i propozuar nuk e ka periudhën minimale prej shtatë (7) vjetësh të kërkuar nga dosja e tenderit. Meqë kemi të bëjmë me kërkesë të detyrueshme të dosjes së tenderit, konsiderojmë se GOE nuk e ka përmbushur kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuar në pikën 1.8 të dosjes së tenderit, pra oferta duhet të vlerësohet në përputhje me kriterin e vendosur dhe oferta të shpallet e papërgjegjshme.

Për këtë arsye, kërkojmë që ky pretendim të shqyrtohet dhe të vlerësohet në raport me pikën 1.8 të dosjes së tenderit, listën e stafit dhe dëshminë e diplomimit të inxhinierit të propozuar, si dhe të konstatohet se kriteri nuk është përmbushur.

Duke u bazuar në analizën profesionale të realizimit të shërbimeve të projektimit, kriteret e vendosura dosjen e tenderit dhe dokumenteve të ofertave përkatëse kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të detyroj Autoritetin Kontraktues të anuloj njoftimin për vendimin e AK B58, të kthejë lëndën në Rivlerësim dhe të shpallë të sukseshëm GOE ENG IDEA SH.P.K. & ARCH EMPIRE L.L.C.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e vendimit të kundërligjshëm të Autoritetit Kontraktues, grupit tonë të operatorëve ekonomikë i është shkaktuar dëm material për shkak të pamundësimit të fitimit dhe realizimit të kontratës, duke humbur të hyrat dhe fitimin e pritshëm për

vlerën 237,093.50 € të kontratës, si dhe duke pësuar shpenzime për përgatitjen e ofertës, zhvillimin e procedurës dhe përmbushjen e obligimeve ndaj stafit dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

a) *1. Njoftimi B58 i rivlerësimit dhe letrat standarde të eliminimit, përfshirë AXIOM–NEWS (f. 2–5), Studio Hapsira–Geoplan–Taulant (f. 6–9) dhe ENG IDEA–ARCH EMPIRE (f. 12–13).*
b) *2. Procesverbali i hapjes B12, 12.05.2026.*
c) *3. Raporti fillestar B36, 22.05.2026, veçanërisht f. 17 dhe 48–52, si dhe vendimi për vlerësim dhe deklaratat nën betim.*
d) *4. Fleta e të Dhënave të Tenderit, nenet 9.1/9.2, dhe Aneksi 6. Njoftimi B05, Dosja e Korrigjuar 2 dhe sqarimi zyrtar i datës 30.04.2026 identifikohen në e-Prokurimi për këtë aktivitet.*
e) *5. Dosja e stafit e grupit tonë, 8.LISTA E STAFIT 2, f. 53–75. Përfshihen diploma dhe kopja noteriale, licenca AKK, kontrata, CV-ja dhe referencat. Për kontrollin e njohjes përdoret vendimi përkatës i njohjes së diplomës. (plotësuar ne ankese dëshmia e ATK-se 2020-2025)*
f) *6. Ekstraktet e stafit të AXIOM, 06.1 dhe 06.2, si dhe dosja e stafit dhe koncepti i Studio Hapsira, në faqet e identifikuara te pretendimet 7.4–7.5.*
g) *7. Për autorizimin e përfaqësimit përdoret deklarata e themelimit të grupit nga oferta origjinale.*

Shenim : të gjitha dokumentat e listuar me siper gjenden ne sistemin e-prokurimi dhe ne ofertat e OE-ve.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*